

**LIGJ**  
**Nr.10 354, datë 18.11.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006 “PËR  
SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 11 “Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Bizneseve, objekt i këtij ligji, të cilat, në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në bazë të vendimit nr. 781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, kanë detyrimin për instalimin e pajisjeve fiskale dhe kanë bërë pagesën e blerjes së pajisjes së parë fiskale deri në datën 28.2.2011 nga “Shoqëritë e autorizuara sipas kontratës përkatëse”, u rimbursohet kjo pagesë deri në shumën 44 000 (dyzet e katër mijë) lekë. TVSH-ja e pajisjes fiskale është e kreditueshme ndaj TVSH-së së llogaritur për bizneset e vogla të regjistruara në TVSH, si dhe për të gjitha bizneset e vogla që regjistrohen në TVSH deri në 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Rimbursimi kryhet në çastin e pagesës së këstit/kësteve pasardhës/pasardhëse të taksës së biznesit të vogël.

Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit.”.

b) Pas pikës 7 shtohet pika 7.1 me këtë përmbajtje:

“7.1. Bizneseve që operojnë në fushën e transportit, përcaktuar në shtojcën 5 të këtij ligji, dhe që kanë detyrimin për t’u pajisur me taksimetër, u rimbursohet pagesa e bërë për blerjen e taksimetrit, sipas kontratës përkatëse, deri në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

Rimbursimi kryhet në çastin e pagesës së këstit/kësteve pasardhës/pasardhëse të taksës së biznesit të vogël.

Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit.”.

c) Pas pikës 7.1 shtohet pika 7.2 me këtë përmbajtje:

“7.2. Bashkitë dhe komunat kompensohen nga Buxheti i Shtetit për efektet e rimbursimit prej tyre të pajisjeve fiskale.”.

**Neni 2**

Në nenin 15 “Mbajtja e regjistrimeve”, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Tatimpaguesit, shitës me pakicë të mallrave ose të shërbimeve, të pajisur me pajisje fiskale, lëshojnë kupon tatimor për çdo shitje. Tatimpaguesit e tjerë, që, në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në bazë të vendimit nr. 781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, nuk janë subjekt i detyrimit për instalimin e pajisjeve fiskale, për çdo shitje të kryer, lëshojnë dëftesë tatimore. Mënyra e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

### Neni 3

1. Aneksi 7, bashkëlidhur ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky ndryshim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## Shpallur me dekretin nr.6794, datë 6.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

### Aneksi 7

### TAKSA E TABELËS

Kategoritë	Niveli i taksës
1) Tabelë për qëllime identifikimi: a) Tabelë për qëllime identifikimi, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 lekë/vit  120 lekë/vit
2) Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: a) Për Bashkinë e Tiranës  b) Për bashkitë qendër qarku  c) Për bashkitë e tjera dhe komonat	45 000 lekë/m <sup>2</sup> /vit deri në sipërfaqen 18 m <sup>2</sup> . Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m <sup>2</sup> paguhet 810 000 lekë/vit.  22 500 lekë/m <sup>2</sup> /vit deri në sipërfaqen 18 m <sup>2</sup> . Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m <sup>2</sup> paguhet 405 000 lekë/vit.  13 500 lekë/m <sup>2</sup> /vit deri në sipërfaqen 18 m <sup>2</sup> . Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m <sup>2</sup> paguhet 243 000 lekë/vit.
3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1000 lekë/m <sup>2</sup> /ditë